Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 282-296/19
Date/Datum. 05.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 282/19
296/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Blerim Dina - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milenković –Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "SALLAHU" SH.P.K. – Kaçanik dhe OE"RSM Company "sh.p.k – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku i rekomanduar për dhinë te kontratës nga ana e AK-së, është OE " ERS BAU" SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI), më datën 04.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, kërkesa e operatorit ekonomik" RSM COMPANY"sh.p.k – Prishtinë e datës : 02.07.2019, për tërheqje nga ankesa e datës: 10.06.2019, me nr. 296/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00 m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK – MI.

II.HEDHET si e pa lejuar ankesa e OE "SALLAHU" SH.P.K. e datës:05.06.2019 me nr. 282/19, në pajtim me nenit 4 parg. 26 pika 1 dhe nenin 99 të LPP-së, si dhe nenin 36 të Rregullores së Punës së OSHP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga AK – MI.

III. I LEJOHET, autoritetit kontraktues /Ministria e Infrastrukturës(MI)/, që të vazhdojë më tutje me procedurat e prokurimit me titull "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga AK– MI.

IV.Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues"SALLAHU SHPK"- Prishtinë,hedhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Me qenëse kërkesa e OE "RSMCOMPANY"aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë. 25.03. 2019
Lloji i procedurës së aplikuar.. Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar. Kontratë publike punë
Vlera e parashikuar e kontratës. 4,300.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52). tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave..03.05.2019
Data e hapjes së ofertave .03.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave. 20.05.2019
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së.. 20.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim "SALLAHU" SHPK: 24.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "SALLAHU" SHPK : 27.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim "RSM COMPANY" SHPK: 27.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "RSM COMPANY" SHPK : 30.05.2019.

Operatori ekonomik ankues OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik, me datën: 05.06.2019, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit:

"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI) duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së.

- Shkelje e nenit 6,54,59,60,68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE "RSM COMPANY" , me datën: 10.06.2019, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI) duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së:

- Shkelje e nenit 59,60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtues tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:26.06.2019 , konstaton dhe sqaron si në vijim:
Përgjigje në Pretendimi nr. 1
Eksperti shqyrtues konstaton se njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 për pjesën 1 dhe pjesën 2, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të projektit me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Nëse OE aplikon për dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohen pajisje për dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1".

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "RSM COMPANY" SHPK, për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht për kërkesën me nr 16 të kësaj liste (Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 7-8 t), ka ofruar

kontrata të shitblerjes të lidhura në mes të "RSM COMPANY" SHPK dhe NTSH "DRINI COMPANY". Mirëpo kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dëshmi për këto pajisje janë kërkuar fatura ose DUDA, dhe në çoftë se nuk i posedon pajisjet, thotë që Operatori duhet të ofroj marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve, marrëveshja duhet të në emër të projektit , me validitet të kohëzgjatjes së të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët si dhe marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.
Autoriteti kontraktues për hir të trajtimit të barabartë ka mundur që konform nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues "RSM COMPANY" SHPK, që të ofroj ndonjë dëshmi shtesë në lidhje me këto pajisje.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2
Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 16 të kësaj liste janë kërkuar Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 7-8 t, dy copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar DUDA Doganor në emër të "EUROFAMIS", Rul për shtrimi e rrugëve e përdorur DV90 VO, viti i prodhimit 2005, numër shasisë H1660082, me peshë bruto 9,400 kg.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3
Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 17 të kësaj liste janë kërkuar Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 12 t, dy copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar Cilindër Bowil tipi TB10000HA, viti prodhimit 1977, pesha neto 10,850 kg, i marruar me huazim nga NP KOLGECI", dhe Cilinder vibrues "Dynapack", viti i prodhimit 1979, numri serik 3DB002824, pesha 6760 kg, të huazuar NP "KOLGECI" .

Përgjigje në Pretendimi nr. 4
Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 18 të kësaj liste janë kërkuar Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 3 t, dy copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar Cilindër "Hamm DV2", tipi 5H1201, viti prodhimit 1989, pesha 2600 kg, i marruar me Kontratë mbi huazim nga NP "KOLGECI", dhe Cilindër "Hamm" tipi HD 10K, viti i prodhimit 1996, numri serik 39643, pesha 2550 kg, i marruar me Kontratë mbi huazim nga "EUROFAMIS" SHA, si dhe Cilindër "Bomag" tipi 100 AD3, numër serik 10115011618, viti i prodhimit 1998, pesha 2470 kg, asnjëri nga këta cilindra nuk e kanë peshën 3 tonë .

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 19 të kësaj liste janë kërkuar Cisterna (tanket) e ujit 3 copë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "RSM COMPANY" SHPK, ku pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar ka paraqitur një fature për cisterne "Majevica 14026" dhe jo Librezën, e ku autocisternat janë makineri qe qarkullojnë në komunikacion dhe patjetër duhet të regjistrohen, eksperti shqyrtues sqaron se me dt:18.09.2019, nga Noteri Minir Zekolli, është përpiluar një Procesverbal mbi Konfirmimin e faktit, në këtë procesverbal ndër pajisjet tjera është e evidentuar Cisterna e ujit "Majevica", e vitit 2001 me faturë 26/2015.

Gjithashtu në kontratën për huazim të lidhur në mes të "ERST BAU SHPK" dhe "FAMIS CO-HC" SHA, tek numrat rendor 24 dhe 25 janë Cisterna Mercedes , tipi 814, nr. Serik G7401115145026, viti 1984, dhe Cisterna FAP, tipi 1213-36, nr. Serik 00036700513004525, viti 1988.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: "OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës se asfaltit" e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: Dëshmitë 8, 9, 10 - Kopja e licencës se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në mes të qiramarrësi dhe qiradhënësit.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës konkretisht lideri i konsorciumit "ERST BAU SHPK", në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi furnizimin me asfalt të lidhur në mes të "ERST BAU SHPK" dhe "I SEFERI" SHPK, me titull të aktivitetit të prokurimit "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, e nënshkruar me

dt:02.05.2019, e vërtetuar nga Noter z. Minir Zekolli, si dëshmi kësaj kontrate ju ka bashkangjitur Leja për aktivitete të veçanta, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në kohëzgjatje deri me 13.04.2019, mirëpo kontratës së noterizuar dhe Lejes si dëshmi shtesë i është bashkangjitur një Njoftim i lëshuar me dt:15.04.2019, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku në të thuhet: Me anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se ndërmarrjen " I. SEFERI" SHPK –Suharekë, me numër të biznesit 70373100, ka aplikuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, për tu licencuar për leje për Aktivitete të Veçanta – Bazë Asfalti me datën 08.04.2019, me numër të aplikacionit 1001, përfaqësuar nga Beqi Sefa.
Kjo ndërmarrje të gjithë dokumentacionin për licencim e ka të kompletuar dhe do të jetë për shqyrtim në mbledhjen e Bordit që do të mbahet, pra ju informojmë se kompania është në procedurë e sipër për tu licencuar.

Gjithashtu /nga Autoriteti kontraktues si dëshmi shtesë një ditë pas dorëzimit të dosjes së AK-së është ofruar Lejen për aktivitete të veçanta, kopje të noterizuar, kjo Leje është e lëshuar në emër të kompanisë "I SEFERI" SHPK, me dt:05.06.2019, dhe me kohëzgjatje deri me dt:22.12.2023.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7
Eksperti shqyrtues konstaton se njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve)", e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: CV e inxhinierit, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Menaxheri duhet të ofroj një deklaratë që nuk është i angazhuar në projekt të MIT (deklaratë e nënshkruar).

Pas analizimit të dosjes së tenderit eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës me Vendim si menaxher të projektit e ka caktuar z.Genc Xhafa i lindur me 04.01.1974, me përgatitje superiore na Universiteti Politeknik i Tiranës (Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale), e ku si dëshmi i ka bashkangjitur Diplomën kopje, kontratën, CV, Letër Referencën, deklaratën si dhe Vërtetimin e lëshuar nga Noteri në lidhje me Diplomën dhe kontratën e punës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se për të njëjtën arsye (Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale), është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit "Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veternik) me nr. prokurimi: MI-19-016-511, Kompania "JOOS KRASNIQI & PEVLAKU", dhe shihet qartë përdorimi i standarde të dyfishtë gjatë vlerësimit nga AK-së, për kompani të ndryshme, eksperti

shqyrtues konstaton se aktiviteti i prokurimit "Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veterrik) me nr. prokurimi: MI-19-016-511, ka të bëjë me aktivitet tjetër të prokurimit .
Gjithashtu eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi në lidhje me Inxhinierin për Ndërtime Civile Industriale, ku Kompania "JOOS KRASNIQI & PEVLAKU", është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit "Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veternik) me nr. prokurimi: MI-19-016-511, ka qenë pretendim ankimor te kërkesa për shqyrtim e dt: 27.05.2019, pranë AK-së, dhe në Vendimin e dt:30.05.2019, për refuzim nuk është dhënë as një arsyetim apo përgjigje në lidhje me këtë pretendim.
Gjithashtu AK-së në vendimin e dt:30.05.2019, dërguar OE ankues "RSM COMPANY" SHP, e pranon që ka pasur lëshime ku Citon: Gjatë vlerësimit të projektit përkatësisht pajisjeve AK-Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, ka vepruar konform nenit 59 paragrafi 4, përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet aq sa është e mundshme dhe të
merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.
Mendimi i ekspertit shqyrtues
Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.

Operatori ekonomik "Sallahu" SHPK –Kaçanik përmes parashtresës me shkrim të datës: 01.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik "RSM COMPANY" –Prishtinë përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 04.07.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesat e operatoreve ekonomik, kërkesat për tërheqjen nga ankesa e OE "RSM Company" Prishtinë, Vendimi Nr. PSH 548/19dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se OE "RSM COMPANY" Prishtinë , me dt. 03.07.2019, ka bëre kërkesë në OSHP duke kërkuar që ti aprovohet kërkesa e tij për tërhiqje nga ankesa e tij me numër 296/19, e datës:10.06.2019, duke u arsyetuar qe për shkak te interesit publik në mënyrë qe mos të ketë pengesa lidhur me zhvillimin e këtij projekti shumë te rëndësishëm dhe për shkak te procedurave te stërzgjatura neve si kompani nuk na konvenon që te vazhdojmë me procedurat e shqyrtimit te mëtutjeshme te ankesës me nr. 296/19, andaj edhe kërkojmë te tërhiqemi nga kjo ankesë.
Paneli shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar kërkesën e OE "RSM COMPAY" Prishtinë të datës 03.07.2019, për tërheqje nga ankesa e dt. 10.06.2019, me nr. 296/19dhe konstaton se e njëjta kërkesë aprovohet si e bazuar sepse ankuesi jep arsye bazike për aprovim dhe se shqyrtimi i pretendimeve ankimore te këtij operatori ekonomik përfundon në ketë fazë.

Paneli shqyrtues konstaton se OE "SALLAHU"SHPK - Kaçanik, ka dështuar të provojë se është palë me interes në aktivitetin e prokurimit në fjalë sepse i njëjti që nga data: 03.07.2019 deri më 03.01.2020, është në Listën e Zezë, andaj në pajtim me nenin 99 të LPP-së ky operator ekonomik nuk mund te merr pjesë në aktivitete të prokurimit dhe te shpërblehet me kontrata derisa është në listën e zezë sipas vendimit të OSHP-së PSH. nr. 548/19 , të dt. 03.07.2019.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në nenin4 paragrafi 26 pika 1 të LPP- së në të cilin thuhet:Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, konstaton se në rastin konkret operatori ekonomik "Sallahu" SHPK- Kaçanik, është operator ekonomik i cili nuk mund të dëshmoj interes material për aktivitetin e prokurimit për te cilin ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 282/19, te dt. 05.06.2019 për faktin se ky operator ekonomik është konstatuar se ka paraqitur dokumente të rreme –falsifikuara në AK MI dhe për të njëjtin operator ekonomik OSHP-ja, ka marr vendim në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së, duke e futur në listën e zeze te njëjtin OE për një periudhe prej gjashtë muajve (6 muajve) , ku këtij operatori ekonomik i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete te prokurimit nga data: 03.07.2019 deri me 03.01.2020.

Paneli shqyrtues sqaron se gjate kësaj periudhe kohore derisa OE " SALLAHU" SHPK- Kaçanik, është në listën e zezë, duke u bazuar në nenin 99 të LPP-së të njëjtit operator ekonomik i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit, sepse neni 99.2 i LPP-së specifikon: Në bazë të një kërkese me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori

ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues "SALLAHU" SHPK Kaçanik, në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi, për arsyet siç u sqarua si me lart.

Paneli shqyrtues për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe rekomandimin për dhinë të kontratës, **konstaton se vet autoriteti kontraktues MI ka përgjegjësi ligjore lidhur me procedurat e udhëhequra**, për faktin se paneli shqyrtues nuk ka vendosur lidhur me shkeljet e supozuara nga OE "SALLAHU" SHPK Kaçanik sepse ankesa e OE " SALLAHU" SHPK Kaçanik, është hedhur si pa lejuar konform vendimin 548/19 te datës 03.07.2019, pretendimet ankimore nuk janë shqyrtuar. Po ashtu as pretendimet e OE "RSM COMPANY " SHPK Prishtinë nuk janë shqyrtuar nga ana e panelit shqyrtues sepse i njëjti OE ka kërkuar që te tërhiqet nga shqyrtimi i mëtejme i ankesës së tij me nr. 296/19 të dt. 10.06.2019.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Ministria e Infrastrukturës (MI),

1x1 OE–"SALLAHU" SHPK-Kaçanik

1x1OE –"RSM COMPANY" Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.